



MOBITEL WIRELESS COMMUNICATIONS SH.A.

VEVE Business Centre
Bulevardi "ZOGU I-rë "
Tirana, ALBANIA

Tel : + 355 4 235 052-3
Fax : + 355 4 235 060-1
E-mail: mobitel@albmail.com

KONTRATË _____

Ne Tirane, me ___/___/ 2009 ndërmjet:

Palëve kontraktuese:

1. **MOBITEL W.L.C** me seli qendrore në Bulevardin Zogu I , i përfaqësuar nga Administratori **Z. Rigels Demiri**, me anë të prokurës së përfaqësimit(nga ketu e më poshtë i quajtur: **Operatori**) dhe
2. (Identiteti i biznesit ose personit dhe adresa e plote) ,
.....
me vendndodhje zyre në, përfaqësuar nga **Z./Znj.**
.....(nga këtu e më poshtë i quajtur: **abonentit**), perfundohet kjo kontrate per kushtet qe vijojne.

Neni 1

OBJEKTI

Operatori i ofron **abonentit** shërbimet e telekomunikacionit nëpërmjet **MOBITEL WLC**, siç parashikohet në Aneksin Nr. 1, i cili konsiderohet si pjese e integruar e kësaj Kontrate, kurse abonentit merr persiper shperblimin e ketij sherbimi dhe pranon kushtet e parashikuar ne Marrëveshjen e Nivelit të Shërbimit 3 (niveli i cilësisë 3), Aneksi Nr. 2, i cili konsiderohet të jetë pjesë e integruar e kësaj Kontrate.

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE KONTRAKTUESE

2 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ABONENTIT

Neni 2

- 2.1 Abonentit ka te drejtë të përdorë shërbimet e telekomunikimit siç parashikohet në Aneksin Nr. 1.
- 2.2 Abonentit me anë të kësaj pranon kushtet siç janë përcaktuar në Marrëveshjen e Nivelit të Shërbimit 3 (Niveli i cilësisë 3), Aneksi Nr. 2.
- 2.3 Abonentit është i detyruar t'i paguajë ofruesit të shërbimit shumën mujore për shërbimet e telekomunikimit të përcaktuara sipas Aneksit Nr. 1, paragrafi 3.3, duke i shtuar TVSH –në, e cila për këto lloj shërbimesh është në shumën 20 % te vleres se fatures.
- 2.4 Aparatura (L3 Communication Prime Wave 2000 SU) i jepet abonentit për përdorim gjatë vlefshmërisë së Kontratës. Abonentit është i detyruar ta mirëmbajë aparaturën e dhënë në përdorim. Në rast dëmtimi, vjedhjeje ose prishjeje, përveç rasteve të forcave madhore ose dëmtimit ose amortizimit të arsyeshëm, abonentit është i detyruar të rimbursojë shumën e plotë të aparatit të përcaktuar në Aneksin Nr. 1, paragrafi 5.
- 2.6 Në rast të mosfunksionimit të aparaturës, abonentit nuk lejohet të hapi ose të riparojë antenën (SU).(UPS) dhe (NTU-Kutia e lidhjes se linjave); por abonentit duhet të informojë operatorin mbi problemin që ka dalë dhe ta lejojë për në vendin ku aparati është instaluar me qëllimin përfundimtar të riparimit ose të zëvendësimit të aparaturës.
- 2.7 Abonentit është i detyruar që t'i sigurojë grupit teknik të Mobitel WLC, mundesi për të bërë të mundur riparimin e pajisjeve dhe zëvendësimin e tyre. Në rast të kundërt, nëse është raportuar problemi nga abonentit dhe hyrja për tek pajisja/aparatura nuk mundësohet, abonentit është i detyruar të paguajë një detyrim ndaj Mobitel WLC, prej 30 USD (\$) për ore.
- 2.8 Abonentit duhet të mirëperdorë rrjetin telefonik dhe të mos shqetesojë te tjeret nepermjet numrit te tij telefonik. Në rast konstatimi dhe perseritje te thirrjeve keqdashese, abonentit i priset automatikisht kontrata dhe paditet ne organet kompetente.
- 2.9 Abonentit është i detyruar të mbrojë nga dëmtimet dhe të ruajë të gjitha pajisjet apo instalimet që ndodhen në territorin e pronës së tij. Operatori është dhe mbetet pronar i paketës së pajisjeve dhe materialeve të instaluar tek abonentit.. Për çdo dëmtim me dashje, abonentit pergjigjet perpara ligjit.
- 2.10 Abonentit qe do te punoje jashte sherbimit familjar ose biznes, per shitje impulsesh me perfitim personal, do te kete kushte te tjera kontraktuale te paracaktuara midis paleve.

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E OPERATORIT

Neni 3

- 3.1 Operatori detyrohet:
 - Të ofrojë shërbimet e telekomunikimit për abonentin, pas pagesës së përcaktuar dhe me përmbushjen e të gjitha kushteve teknike nga abonentit (konfigurimi i aparaturës dhe ofrimi i lidhjes fizike me vendin e destinacionit).
 - Në rast të ndërprerjes së energjisë, operatorit mund të ofrojë një lidhje cilësore deri në 2 (dy) orë përgjatë kohës së ndërprerjes së energjisë dhe ky rast do të konsiderohet si Forcë Madhore.
- 3.2 Operatori ka të drejtë:
 - Të ndërpresë shërbimet e komunikimit përkohësisht, deri në 2-muj. Pas kesaj peridudhe, Operatori ka te drejte te prishet kontraten.
 - Për pagesat e vonuara të shërbimeve, operatorit ruan të drejtën e llogaritjes së interesit së kamatës sipas ligjit.
- 3.3 Operatori merr persiper te njoftoje 1-muj me pare Abonentin, ne rast te ndryshimit te tarifave te sherbimit.

FORCAT MADHORE
Neni 4

- 4.1 Operatori dhe abonenti bien dakord se asnjëra nga palët kontraktuese nuk do të jetë përgjegjëse ndaj njera tjetrës ndaj çdo humbjeje, dëmtimi, ose mospërbushjeje të klauzolave të kësaj Kontrate për arsye të Forcës Madhore.
- 4.2 Për këtë qëllim Forcë Madhore konsiderohet çdo rrethanë përtej kontrollit të Palëve kontraktuese, dhe e pavarur nga vullneti i paleve, e cila nuk mund të parandalohet ose të eliminohet dhe që mund të ndodhë pas firmosjeje së kësaj Kontrate dhe ato pengojnë plotësisht ose pjesërisht zbatimin e detyrimeve kontraktuese.
- 4.3 Gjatë periudhës së Forcës Madhore, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo Kontratë do të pezullohen.
- 4.4 Nëse përbushja e detyrimeve kontraktuese do të vonohet për shkak të Forcës Madhore, për më shumë se 6 muaj, palët kontraktuese mund të vendosin kushte të reja për përbushjen e kësaj Kontrate, ose kushte për përfundimin e kësaj Kontrate.

MËNYRA E PAGIMIT
Neni 5

- 5.1 Abonenti do të kryejë pagesën pas lëshimit të Faturës së mëparshme, prane zyrave të Mobitel W.L.C
- 5.2 Afati i fundit për pagesën është data 20 e cdo muaji. Pas kesaj date deri ne fund te muajit duhet te kryhet pagesa e plote per sherbimin e kryer.
- 5.3 Në rast të vonësës së mundshme të pagesës, operatori ruan të drejtën e llogaritjes së interesit të kamatës sipas ligjit.

KOHËZGJATJA E KONTRATËS
Neni 6

- 6.1 Kjo Kontratë është e vlefshme për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) mujore.
- 6.2 Kjo Kontratë do të zgjatet automatikisht nëse secila nga palët kontraktuese nuk dërgon njoftim me shkrim për anulim brenda 30 ditëve përpara përfundimit të saj.

NDËRPRERJA E KONTRATËS
Neni 7

- 7.1 Abonenti mund ta ndërpresë Kontratën me anën e një njoftimi me shkrim për operatorin e cila dorëzohet të paktën 30 ditë para përfundimit të Kontratës, dhe ai është i detyruar të kryejë të gjitha pagesat e detyrimeve ndaj operatorit, të paguajë në mënyrë të plotë sipas çmimit të vendosur në Aneksin Nr. 1 paragrafi 3, brenda periudhës së përdorimit të shërbimit.
- 7.2 Abonenti mund ta ndërpresë Kontratën:
- nëse ofruesi i shërbimit nuk është në gjendje të sigurojë shërbim cilësor të shërbimit brenda një muaji kalendarak;
 - Operatori nuk ofron shërbimet e komunikimit ndaj abonentit brenda **2-3 dite** pas kryerjes së pagesës dhe pas plotësimit të kushteve teknike të nevojshme nga abonenti (konfiguron aparaturën dhe nuk ofron lidhjen fizike me vendin e destinacionit);
 - Në rast se operatori nuk është i aftë të ofrojë shërbimet për shkak të Forcave Madhore për më shumë se 6 (gjashtë) muaj.
- 7.3 Operatori mund ta ndërpresë Kontratën:
- nëse nuk bëhet përbushja e detyrimeve kontraktuese nga ana e Abonentit. Në këtë rast, operatori ka të drejtën të faturojë penalitetet për ndërprerjen e parakohshme të Kontratës në përputhje me paragrafin 7.1 të këtij Neni.
 - Në rast se operatori nuk mundet të ofrojë shërbimet për shkak të Forcave Madhore për më shumë se 6 (gjashtë) muaj.
 - Në rast të prishjes së kontratës, për çdo lloj arsyeje, pagesa e tarifës fillestare, është e pakthyeshme.

GJYKATA KOMPETENTE
Neni 8

Palët bien dakord se çdo mosmarrëveshje në lidhje me Kontratën do të zgjidhet fillimisht me mirëkuptim me diskutim të përbashkët. Nëse mosmarrëveshja ngelet e pazgjidhur, çështja do të referohet Gjykatës kompetente.

HYRJA NË FUQI
Neni 9

Kjo Kontratë do të hyjë në fuqi në ditën e firmosjes nga të dyja palët kontraktuese. Kontrata do të përpilohet në 2 (dy) kopje në shqip. Abonenti do të marrë 1 (një) kopje të kontratës së firmosur, bashkëngjitur të gjitha dokumentacionin tjetër plotësues (Aneksi 1), kurse Operatori do të marrë 1 (një) kopje të kontratës së firmosur.

Tiranë më, ___/___/2009

PALËT KONTRAKTUESE

Mobitel W.L.C
Operatori

Sales Manager

Z.Rigels Demiri
Administrator

ABONENTI

(Emer Mbiemer Firme)

VULA

Aneksi 1. i Kontratës Nr. ____ Datë ____/____/2009

1. Të dhënat e Abonentit:

| |
|--|
| Emri dhe Selia e Personit Juridik: |
| Adresa: |
| Numri Unik i Identifikimit: |
| Numri Tatimor: |
| Kontakti Administrues: Z./Znj. |
| Kontakti i Teknikës: Tel: 048-300 000/ 300 301/ 300 312 |
| Adresa ku do të dërgohen faturat: |
| Personi i Kontaktit: |
| Tel/faks: |

2. **SHËRBIMET**, ofruesi i shërbimit me kërkesë të abonentit sipas kushteve të përcaktuara në Kontratën Bazë ____ / ____ /2009 ofron shërbimet e mëposhtme:

Nr. Telefoni: 048 _____
Nr. Telefoni & internet 048 _____

2.1 **Shërbimet e Telekomunikimit**

2.2 **Ndihme Teknike – Niveli i cilësisë (3)**

Ndihma teknike përcaktohet në Marrëveshjen e Nivelit të Shërbimit Nivelit të cilësisë (3) Aneksi Nr. 2, i cili konsiderohet të jetë pjesë e integruar e kësaj Kontrate.

2.4 Me këtë Aneks, do të jenë të vlefshme klauzolat e Kontratës ____/____/2009, të rëna dakord ndërmjet MOBITEL WLC dhe abonentit.

3. **ÇMIMI i shërbimit:**

3.1 Tarifa e instalimit per nr/telefoni _____ Leke
3.2 Tarifa e instalimit per internet _____ Leke
3.3 Tarifa e shërbimit mujor (taksa mujore) _____ Leke
3.4 Tarifa e shërbimit per fature te detajuar _____ Leke
3.5 Pagesa mujore _____ Linja Shtese _____

4. **VLERA E APARATURËS**

4.1 "L3 Communication Prime Wave 2000"

SU per dy abonente, 700 \$ (dollare amerikane) dhe
per SU tete abonentesh, 2000 \$ (dollare amerikane)

**Kjo nuk faturohet, aparatura jepet për përdorim për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së Kontratës.*

Në çmim nuk përfshihet Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) nga 20 %.
Ky Aneks është i vlefshëm nga data 15.01.2007

Në Tiranë nga data ____/____/2009

PALËT KONTRAKTUESE
Mobitel W.L.C
Operatori

Sales Manager

Z.Rigels Demiri
Administrator

ABONENTI

(Emer Mbiemer Firme)

VULA

Aneksi 2.

Për KONTRATËN ___/___/2009 për përdorimin e shërbimeve të telekomunikimit

Në përputhje me Kontratën për përdorimin e shërbimeve të telekomunikimit të rënë dakord më datë ___/___/2009 në Tiranë, ndërmjet palëve kontraktuese MOBITEL W.L.C dhe _____, palët kontraktuese ranë dakord të pranojnë kushtet me garantimin e nivelit të cilësisë (**Marrëveshja e Nivelit të Shërbimit**).

Sipas opsionit të telekomunikimit të pranuar nga abonenti, palët kontraktuese ranë dakord të përmbushin detyrimet e mëposhtme për të mundësuar një shërbim cilësor.

I. INSTALIMI

Lidhja tek abonenti do të instalohet brenda 3-diteve pas kryerjes së pagesës në përputhje me Nenin 2, paragrafi 2.1 të Kontratës për përdorimin e shërbimeve të telekomunikimit.

1.1 Abonenti i shërbimit merr përsipër detyrat e mëposhtme:

- Të sigurojë njësinë e nevojshme (një telefon) i cili do të kryejë lidhjen e telekomunikimit.
- Një përfaqësues i abonentit fundor do të bashkëpunojë me **MOBITEL W.L.C** gjatë procesit të instalimit.
- Abonenti, ose përfaqësuesi i tij duhet të jenë fizikisht të pranishëm gjatë kohës së instalimit.
- Abonenti është personi i vetëm i cili mund të kryejë komunikimin ndërmjet zotëruesit të objektit (ndërtesës) dhe MOBITEL W.L.C. Abonenti do të sigurojë të gjitha lejet e nevojshme për instalimin, kalimin për në çatinë e ndërtesës ose në secilin vend të përshtatshëm për instalimin e antenës, e cila do të vendoset në vendin e përcaktuar paraprakisht, si dhe për rrugën që do të ndjekë kabllin.
- Të gjitha kërkesat e veçanta për instalimin të cilat do të kërkohen, si dhe kalimi i kabllit nën qilim, përmes mureve, prapa dollapëve, ose nëpër kanalina mund të paguhen shtesë.
- MOBITEL W.L.C nuk është përgjegjëse për çdo dëm ndaj objektit të cilët shkaktohen si rezultat i instalimit ose i zëvendësimit të aparaturës, por jo vetëm në, vrima në mure, linjat kabllore, linjat elektrike dhe mbajtësja e antenës.
 - Poseduesi i antenes (SU) duhet të sigurojë me energji elektrike aparatit e quajtur UPS, me një fuqi nga 22-35 Wat, në varesi të tipit të antenes, dhe kjo të jete sa me afër UPS-se.

1.2 MOBITEL W.L.C e konsideron instalimin e përfunduar plotësisht kur plotësohen si më poshtë:

- Vendoset antena (nëse ka një antenë në objekt, kabllin shkon në prizën më të afërt).
- Kabllin mbërrin në pikën e caktuar nga abonenti.
- Aparati telefonik provohet me sukses për lidhjen.
- Firmosja e porosisë së punës nga ekipi i cili kreu instalimin dhe abonenti.

1.3 MOBITEL W.L.C. nuk është e detyruar të lidhë të gjithë aparatet telefonikë privatë. Këto shërbime paguhen shtesë. Detyra e MOBITEL është të kryejë lidhjen në një linjë ose në një aparat telefonik.

1.4 Në rast se **MOBITEL W.L.C** nuk ka plotësuar detyrimin për instalimin e suksesshëm, shumica e parapaguar për instalimin do t'i rikthehet abonentit.

1.5 Ndryshimet në planin e instalimit në afatin e përmendur më sipër, mund të rezultojnë në vonesën e instalimit, në rast se MOBITEL W.L.C ndalohet të kryejë instalimin për shkak të problemeve teknike ose për arsye që janë jashtë kontrollit (Forcës Madhore) të MOBITEL Tiranë.

II. Garancia e shërbimit

Operatori është i detyruar të ofrojë shërbimin e kërkuar me cilësi të lartë gjatë gjithë periudhës së muajit përkatës sipas kontratës 12 (dymbëdhjetë) mujore.

Shërbimi nuk do të konsiderohet si i ofruar pas raportimit të mëparshëm me telefon të problemit nga abonenti dhe operatori verifikon se problemi ka ardhur nga konfigurimi lokal i rrjetit të abonentit.

Per shërbimin INTERNET (64 dail-up), konfigurimi i kompjuterit perkates, behet nga vete abonenti.

III. KOHA E NEVOJSHME PER ZGJIDHJEN E PROBLEMIT

1. Niveli i cilësisë 3 (MNSH 3)

Abonenti është i detyruar të raportojë problemin me telefon tek shërbimi teknik i MOBITEL W.L.C ne telefonat e mesiperm. Abonenti është i detyruar të bashkëpunojë me teknikun e MOBITEL W.L.C. Me raportimin e problemit me anën e telefonit, tekniku i MOBITEL W.L.C do të përpiqet të zgjidhë problemin së pari p.sh. tekniku do të informohet nga abonenti i shërbimit. Në rast se problemi nuk mund të zgjidhet me anën e telefonit, ekipi i teknikëve do të mbërrijë për një ndërrhyrje të jashtme.

Operatori është i detyruar të mbërrijë tek abonenti 8 (tetë) orë pas raportimit të problemit me anën e telefonit brenda ditës së punës, e cila është nga ora 08 deri në 16. Në rast se problemi është raportuar gjatë ditës së punës, ofruesi i shërbimit është i detyruar të arrijë tek abonenti gjatë ditës pasardhëse të punës deri në skadimin e 8 (tetë) orëve të punës. Operatori në rastet e forcës madhore ose të situatave të paparashikuara mund të vonohet në afatin e mbërritjes tek abonenti.

2. Ndërrhyrja, p.sh. zgjidhja e problemit nga operatori, në përputhje me sa më sipër do të kryhet gjatë javës së punës.

IV Informimi për problemet e parashikuara

Informacioni për problemet e parashikuara nga MOBITEL W.L.C për abonentin mund të kryhet nëpërmjet:

- *e-mail*
- *telefon*

V Ruajtja e Fshehtësisë

MOBITEL W.L.C është i detyruar të mos zbulojë asnjë informacion dhe të dhënë rreth klientëve të saj, vetëm me Kërkesë të Gjykatës

VI Një garanci për rifillimin e shërbimit brenda 24 orëve.

MOBITEL W.L.C per raste te difekteve te renda si psh.: stacion transmetues (RBU); centralin (NIU); sistemet e transmetimit radiorele: do te beje te gjitha perpjekjet per ta zgjidhur sa me shpejt difektin. N.q.s difekti do te zgjase mbi 3-dite, ofruesi i shërbimit është i detyruar ti njoftoje me shkrim abonentit perkates duke sqaruar problemin dhe afatin e riparimit.

Abonenti bie dakord se do të mundësojë kalimin absolut për riparimin, instalimin ose mirëmbajtjen e aparaturës. Në rast se këto kushte nuk plotësohen garancia nuk është e vlefshme.

VII Shërbimi i planifikuar i mirëmbajtjes

MOBITEL W.L.C është e detyruar të kryejë mirëmbajtjen e planifikuar të rrjetit të kryer me:

- Mirëmbajtjen e planifikuar të pajisjeve të stacionit bazë të dielave.
- Mirëmbajtjen e Soft –ve dhe superstrukturave në periudhën nga ora 00 deri në 06

MOBITEL W.L.C është e detyruar të informojë abonentin nëpërmjet postës për mirëmbajtjen e stacionit bazë. Periudha e njoftuar kur shërbimi nuk do të jetë i mundur, nuk do të konsiderohet si ndërprerje e lidhjes.

VIII. Garancia e kufizuar, shërbimi, riparimi, dhe interferencat

MOBITEL W.L.C do të sigurojë pjesë të kufizuara dhe punën për instalimin e kablove dhe të aparaturave pa tela për 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e instalimit. Instalimet nuk përfshijnë dëmet si rezultat i pakujdesisë ose Forcave Madhore.

Abonenti është i detyruar që çdo lloj sulmi elektro-magnetik, frekuencë radioje ose interferenca të tjera të cilat sipas kuptimit të MOBITEL W.L.C, ndikojnë në shërbimin e komunikimit dhe shkaktohen nga instrumente që janë vendosur në, ose mbi objekt, ato do të shkëputen menjëherë derisa niveli i tyre i interreferencës nuk plotëson kriteret e MOBITEL W.L.C.

IX. Statistikat e përdorimit

Me kërkesën e abonentit, MOBITEL W.L.C mund të sigurojë një listë të detajuar të të gjitha thirrjeve dalëse.

X. Detyrat e abonentit

Abonenti nuk do të:

- Rishesë shërbimin pa pasur njoftim me shkrim më parë nga MOBITEL W.L.C
- Operojë si një ofrues shërbimit të telekomunikimit

Në Tiranë më, ___/___/2009

PALËT KONTRAKTUESE

Mobitel W.L.C
Operatori

Sales Manager

Z.Rigels Demiri
Administrator

ABONENTI

(Emer Mbiemer Firme)

VULA